



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 034/24 Dt. 31.01.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 paragrafi g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 13 të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, mori këtë:

V E N D I M

Për caktimin e zyrtarit përgjegjës për qasje në dokumente publike

1. Adelina Hoxhaj, zyrtare për dokumentacion dhe informim në Njësinë për Komunikim me Publikun në Komunën e Prizrenit, caktohet si zyrtare përgjegjëse për qasje në dokumente publike në Komunën e Prizrenit.
2. Detyra dhe përgjegjësit e zyrtares të caktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi janë të parapara në Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
4. Obligohet zyrtarja e lartcekur dhe Drejtoritë/Njësit përkatëse relevante, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Njesisë për Komunikim me Publikun,
 - Organeve kompetente,
 - Të lartcekurës,
 - Arkivës së Kryetarit.

